

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Menaxhment
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Semestri:	II
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ofron një bazë të gjerë dhe të qëndrueshme mbi konceptet thelbësore dhe funksionet kryesore të menaxhimit, duke përfshirë menaxhimin strategjik, organizativ, operacional dhe të burimeve njerëzore, në kontekstin e një mjedisi dinamik, të globalizuar dhe gjithnjë e më të digjitalizuar. Theksi vihet në zhvillimin e aftësive për vendimmarrje të bazuar në të dhëna, lidërsip efektiv dhe aftësi për të menaxhuar kompleksitetin organizativ në kohën e transformimeve teknologjike. Përmes qasjeve bashkëkohore si menaxhimi i inovacionit, aplikimi i teknologjive të informacionit dhe ndikimi i inteligjencës artificiale në proceset menaxheriale, studentët do të përgatiten për sfidat reale dhe të shumëllojshme që karakterizojnë organizatat moderne publike dhe private. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njihen me menaxhmentin si shkencë dhe si profesion, me karakteristikat e afarizmit bashkëkohor dhe me kontekstin organizativ ku funksionojnë bizneset. Rëndësia e menaxhimit në mbijetesën, zhvillimin dhe rritjen e organizatave do të trajtohet përmes analizës së rolit të tij në marrjen me kohë të vendimeve strategjike që ndihmojnë në përballimin e konkurrencës dhe përshtatjen me mjedisin ekonomik ku operojnë. Gjithashtu, lënda synon që studentët të fitojnë njohuri praktike dhe teorike mbi proceset menaxheriale dhe funksionet kryesore të menaxhimit, duke përfshirë planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin, si dhe të zhvillojnë aftësi kritike dhe analitike për zgjidhjen e problemeve organizative.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi themelor i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuri themelore dhe të strukturuar mbi rolet, përgjegjësitë dhe funksionet kryesore të një menaxheri brenda një organizate biznesi po jo vetëm. Përmes analizës së detajuar të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm ku operojnë ndërmarrjet, studentët do të zhvillojnë aftësinë për të marrë vendime menaxheriale me një shkallë të lartë

	efektiviteti dhe përshtatjeje strategjike. Lënda synon gjithashtu të zhvillojë tek studentët një qasje kritike dhe analitike ndaj përdorimit racional të teknikave bashkëkohore të menaxhimit, si mjete ndihmëse për përmirësimin e cilësisë së proceseve menaxheriale.Përmes studimit të rasteve konkrete dhe zbatimit të teorive në praktikë, studentët do të orientohen drejt ndërtimit të një vizioni të qartë dhe profesional mbi menaxhimin efektiv në mjedise komplekse dhe në zhvillim të vazhdueshëm.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Shpjegojnë zhvillimin historik të menaxhmentit dhe evoluimin e organizimit të punës, duke identifikuar kontributet kryesore teorike dhe qasjen në fushën e menaxhimit. ECTS: 1 2. Zhvillojnë struktura organizative dhe të aplikojnë parimet themelore të menaxhimit në praktikë, në funksion të efikasitetit organizativ. ECTS: 1 3. Kuptojnë dhe interpretojnë veçoritë dhe tendencat e menaxhimit bashkëkohor, përfshirë qasjet strategjike, inovative dhe teknologjike në drejtimin e organizatave. ECTS: 1 4. Zhvillojnë aftësinë për të marrë vendime menaxheriale të argumentuara, të bazuara në analiza të të dhënave dhe të mjedisit organizativ. ECTS: 1 5. Aplikojnë parimet e komunikimit efektiv, planifikimit, organizimit dhe kontrollit, si komponentë thelbësorë të procesit menaxherial. ECTS: 1 6. Analizojnë dhe përshtatin strategjitë menaxheriale për t’u përballur me sfidat dhe ndryshimet, në mjediset ekonomike, teknologjike dhe sociale në zhvillim të vazhdueshëm. ECTS: 1,		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte			
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	12	24
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45
Përgatitja përfundimtare në provim	4	3	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet etj	2	2	4
Totali			150
Metodologjia e	Ky kurs zhvillohet përgjatë një semestri prej 15 javësh, përmes sesioneve		

mësimdhënies dhe mësim-nxënies	të rregullta javore që përfshijnë 3 orë leksione dhe/ose ushtrime. Mësimdhënia është konceptuar në mënyrë të integruar për të përforcuar lidhjen ndërmjet njohurive teorike dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë, duke kontribuar drejtpërdrejt në arritjen e rezultateve të synuara të nxënies. Procesi mësimor bazohet në një qasje të kombinuar didaktike, që përfshin: • Ligjërata të strukturuar me përdorimin e mjeteve bashkëkohore audio-vizuale (PowerPoint, videomateriale, etj.), që ofrojnë një pasqyrë të qartë të koncepteve kyçe të menaxhimit në kontekstin modern. • Ushtrime individuale dhe grupore, të fokusuar në zbatimin praktik të teorive menaxheriale, analizën e rasteve studimore, zgjidhjen e detyrave numerike dhe interpretimin e rezultateve në mënyrë analitike. • Diskutime të strukturuar në klasë, që stimulojnë të menduarit kritik, reflektimin dhe ndarjen e përvojave përmes ndërveprimit professor-student dhe student-student. • Punime seminarike dhe detyra, të cilat nxisin zhvillimin e aftësive kërkimore, analitike dhe të komunikimit profesional në fushën e menaxhimit. • Përdorimi i teknologjisë së informacionit, përfshirë programet dhe platforma më të reja digjitale, për të përforcuar procesin e të nxënit dhe për të simuluar situata reale të menaxhimit në organizata bashkëkohore. Pjesëmarrja aktive e studentëve konsiderohet thelbësore për suksesin e procesit mësimor. Studentët inkurajohen të ndjekin rregullisht të gjitha sesionet dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në diskutime, analizime të rasteve dhe punë praktike. Kjo metodologji synon të forcojë kompetencat teorike dhe praktike të studentëve, duke i përgatitur ata për rolin e menaxherit në mjediset dinamike dhe të globalizuara të biznesit modern.
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 10 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminari..max 20 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	6
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	8
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	6
Gjithsej:	20

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejt të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjëruar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**30 pikë (%)**,
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....**40 pikë (%)**

	Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela-Smart, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulën e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në ushtrime/detyra praktike. • 105 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulën e lëndës. • 45 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektesh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 2 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Stephen P. Robbins, Mary Coulter & David De Cenzo “Foundation of Management”, Eleventh edition, 2020, Pearson, 2. Shyqri LLACI “Manaxhimi”, Tiranë 2012																												
Literatura shtesë	1. A. Loku & E.Neziraj; Ligjerata të Autorizuara „Bazat e Menaxhimit dhe Teknologjia Informative” Prishtinë 2022																												
<u>Informacion shtesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	1. A.Loku & N.Loku; Paper; “<i>Globalization, Automation, and the Future of Work: Examining the Impact of Technological Advancements on the Workforce</i>”, 2025, Journal: “QUALITY - Access to Success”; ISSN:1582-2559; Linku i punimit: 20241226_1ca17576-0a92-4e1e-bb12-fdfd2c14b3f4.pdf																												
Plani i dizajnuar i																													

mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi i lëndës dhe hyrje në menaxhment; Kush janë menaxherët? Pse të studiojmë menaxhment? Funksionet e menaxhimit. <i>Literatura:</i> (Robins, Coulter & DeCenzo, 2020 Fq. 24-47.) Rezultati i pritur nr. 1, 2 & 5
Java e dytë	Zhvillimi historik i shkencës së menaxhimit: Shkollat klasike, shkolla e sjelljes dhe shkolla sasiore, perspektivat e reja në menaxhim, dhe teoritë moderne të menaxhimit <i>Literatura:</i> (Robins, Coulter & DeCenzo, 2020, Fq. 49-56) Rezultati i pritur nr. 1 & 3
Java e tretë	Kultura organizative: Përkufizimi i kulturës organizative dhe ndikimi i saj në punën e menaxherëve dhe punonjësve, ambienti i jashtëm organizativ dhe rëndësia e tij, roli i të dhënave demografike në mjedisin e punës. <i>Literatura:</i> (Robins, Coulter & DeCenzo, 2020 Fq. 56-80) Rezultati i pritur nr. 3, 5 & 6
Java e katërt	Procesi i vendimmarrjes: Metodat sasiore të vendimmarrjes, Përcaktimi i procesit të vendimmarrjes, Kushtet në të cilat menaxherët marrin vendime (siguria, rreziku dhe pasiguria). Problemet bashkëkohore me të cilat përballen menaxherët gjatë marrjes së vendimeve sot. (Robins, Coulter & DeCenzo 2020 Fq. 110-151) Rezultati i pritur nr. 3, 5 & 6
Java e pestë	Papunësia dhe sfida e personelit në sektoret kryesore përball revolucionit teknologjik: Shërbimet administrative, sektori bankar dhe ai i Sigurimeve, shërbimimet e ushqimit, transporti, rrjetet e të dhënave, arsimi, arti, muzika, tregtia e lirë, punësimi dhe sektorit publik. Literatura: A.Loku & N.Loku; Punimi: “Globalization, Automation, and the Future of Work: Examining the Impact of Technological Advancements on the Workforce”, 2025, Rezultati i pritur nr. 2, 4 & 6
Java e gjashtë	Bazat e Planifikimit: Përkufizimi dhe rëndësia e planifikimit menaxherial. Menaxhimi strategjik dhe rëndësia e tij për menaxherët. Qëllimet dhe planet: llojet dhe rëndësia e tyre. Çështjet bashkëkohore në planifikim. <i>Literatura:</i> (Robins, Coulter & DeCenzo, 2020, Fq.152-182) Rezultati i pritur nr. 2, 3 & 5
Java e shtatë	Struktura Organizative: Elementet kryesore të strukturës organizative:specializimi,departamentet, autoriteti, përgjegjësia, kontrolli, centralizimi/decentralizimi dhe formalizimi. Faktorët rastësorë që ndikojnë në zgjedhjen strukturore. Modelet e strukturave organizative dhe sfidat e tyre <i>Literatura:</i> (Robins, Coulter & DeCenzo, 2020, Fq.182-218) Rezultati i pritur nr. 2, 5 & 6
Java e tetë	Testi i Parë
Java e nëntë	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore: Procesi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe faktorët që e ndikojnë atë. Rekrutimi dhe përzgjedhja e punonjësve. Trajnimi dhe zhvillimi i stafit. <i>Literatura:</i> (Robins, Coulter & DeCenzo, 2020, Fq. 219-254) Rezultati i pritur nr. 3, 5 & 6
Java e dhjetë	Menaxhimi i Ndryshimit dhe Inovacionit:

	Përkufizimi i ndryshimit organizativ. Strategjitë e menaxhimit të rezistencës ndaj ndryshimit. Reagimet e punonjësve ndaj ndryshimit. Nxitja e inovacionit në organizatë. <i>Referenca:</i> (Robbins, Coulter & DeCenzo, 2020 Fq. 258-286) Rezultati i prituri nr. 3, 5 & 6
Java e njëmbëdhjetë	Bazat e sjelljes individuale: Fokusi dhe qëllimet e Sjelljes organizative. Çfarë roli luajnë qëndrimet në performancën e punës? Çfarë duhet të dinë menaxherët për personalitetin? Çfarë është perceptimi dhe çfarë ndikon në të? (Robbins, Coulter & DeCenzo, 2020 Fq. 286-320)
Java e dymbëdhjetë	Motivimi dhe Shperblimi: Fokusi dhe qëllimet e sjelljes organizative. Ndikimi i qëndrimeve në performancë. Roli i personalitetit në punë. Perceptimi dhe faktorët që e ndikojnë atë. <i>Literatura:</i> (Robbins, Coulter & DeCenzo, 2020 Fq. 350-382) Rezultati i prituri nr. 3, 5 & 6
Java e trembëdhjetë	Menaxhimi i Sistemeve informative: <i>Literatura:</i> A. Loku & E. Neziraj; „Bazat e Menaxhimit dhe Teknologjia Informative” 2022, Fq. 249-315 Rezultati i prituri nr. 3, 5 & 6
Java e katërbëdhjetë	Bazat e Kontrollit dhe Menaxhimi i Operacioneve: Përkufizimi dhe rëndësia e kontrollit. Procesi i kontrollit menaxherial. Fushat që duhet të monitorojnë menaxherët. Sfidat bashkëkohore në menaxhimin e operacioneve <i>Literatura:</i> (Robbins, Coulter & DeCenzo, 2020 Fq. 442-503) Rezultati i prituri nr. 3 & 6
Java e pesëmbëdhjetë	Testi dhe Provimi përfundimtar
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi do të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	